

Vendim nr. 148, datë 06.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 06.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (K) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KLODIAN RJEPAJ**, përfaqësuar nga avokati Tritan Hamitaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-699, datë 24.04.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 17, 27, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 135, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71, pika 3, shkronja “e” dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), në kuadër të procedimit penal nr. 13, datë 13.01.2020 (*procedimi penal nr. 13/2020*), të regjistruar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të kryer në bashkëpunim dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 e 25, 258 e 25 dhe 260 të Kodit Penal (*KP*). Në vijim të hetimeve paraprake të këtij procedimi penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar edhe veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim me pasoja të rënda, të parashikuara nga nenet 186, paragrafi i tretë e 25 dhe 143, paragrafi i dytë dhe i tretë, të KP-së. Prokuroria ka regjistruar edhe emrat e autorëve të dyshuar të këtyre veprave, përfshirë kërkuesin, i cili është dyshuar si autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët e dytë dhe të tretë e 25, 186, paragrafi i tretë e 25, si dhe 248 e 25 të KP-së.

2. Objekt i hetimit janë veprimet/mosveprimet që lidhen me procedurën publike të finalizuar me kontratën e koncesionit të datës 10.12.2015 (*kontrata e koncesionit të sterilizimit*), me objekt dhënien me koncesion/partneritet publik privat të shërbimit publik të ofrimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale, me afat 10-vjeçar dhe vlerë totale 9.657.000.000 lekë (pa TVSH), të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe shoqërisë “X” sh.p.k., sikundër edhe veprimet/mosveprimet në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate.

3. Kërkuesi, i cili ka ushtruar detyrën e zëvendësministrit të Shëndetësisë, ka qenë kryetar i Komisionit të Dhënies me Koncesion/Partneritet Publik Privat (*PPP*) dhe në këtë cilësi ka pasur detyrë përgatitjen e situatës së fizibilitetit të kontratës së koncesionit të sterilizimit, përlogaritjen e vlerës së saj dhe përgatitjen e dokumenteve standarde të koncesionit. Nga hetimet është ngritur dyshimi se nuk është bërë asnjë studim i saktë për elementet përbërëse të kostos së shërbimit, duke u paraqitur të dhëna të pasakta për numrin, llojin ose kriteret për klasifikimin e kategorive të intensitetit të ndërhyrjeve në spitale që

reflektohen në pasqyrat financiare, duke krijuar dëm në buxhetin e shtetit. Po ashtu, është ngritur dyshimi se nuk është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i instrumenteve kirurgjikale dhe pajisjeve të sterilizimit, për të nxjerrë më pas nevojat reale për plotësimin ose zëvendësimin total të tyre etj. Për këto arsye, kërkuesi është dyshuar se ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrën, si dhe se nuk ka deklaruar konfliktin e interesit, në kushtet kur më herët ka pasur njohje me një prej ortakëve të shoqërisë fituese të koncesionit të sterilizimit.

4. Në vijim, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 49, datë 23.06.2023, mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg” dhe me vendimin nr. 102, datë 18.08.2023 ajo gjykatë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të kësaj mase. Kundër këtyre vendimeve kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 44, datë 04.10.2023, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-116, datë 25.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 29.03.2024 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 13/2020, duke ngritur ndaj kërkuesit akuzën për kryerjen e veprave penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim me pasoja të rënda, “Falsifikimi i dokumenteve”, të kryer në bashkëpunim dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 143, paragrafi i dytë dhe i tretë, 186, paragrafi 3, dhe 25, si dhe 248 e 25 të KP-së. Në seancën e datës 23.12.2024, duke mbajtur parasysh se kërkuesi së bashku me të pandehurit e tjerë kanë pasur për qëllim përvetësimin e fondeve publike, bazuar në nenin 332/d, pika 3, të KPP-së, gjyqtari i seancës paraprake ka ftuar organin e akuzës që të bëjë cilësimin e fakteve penale në ngarkim të tyre, ftesë e cila është pranuar, duke u bërë ndryshimi i akuzës për disa nga veprat penale për të cilat ishte dërguar çështja penale në gjykim, duke u akuzuar kërkuesi për veprat penale të parashikuara nga nenet 135, 28, pika 4, 186, pika 3 dhe 334, pika 1, të KP-së. Pas këtij momenti procedural gjykata u ka lënë kohë për të përgatitur mbrojtjen kërkuesit dhe avokatit të tij.

7. Ndërkohë, në datën 17.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për të cilin Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 260,

datë 08.11.2024, ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare, duke vlerësuar se pretendimet për kufizimin e lirisë personale. për shkak të caktimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të lidhur me arsyetimin e vendimit gjyqësor, janë haptazi të pabazuara, në kushtet kur masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e saj.

8. Në datën 06.01.2025 kërkuesi ka paraqitur përpara gjykatave të zakonshme kërkesë për konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe caktimin e një mase më të butë, nëse gjykata do të vlerësonte se ishin ende kushtet për caktimin e një masë siguri. Sipas tij, ishin plotësuar kushtet e nenit 263, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, pasi kishin kaluar 6 muaj nga fillimi i zbatimit të paraburgimit pa u dorëzuar aktet në gjykatë. Sipas tij, seanca e parë gjyqësore përpara gjyqtarit të seancës paraprake ishte caktuar pas 8 muajsh paraburgim dhe kërkuesi dyshohej për vepra penale që kishin një masë dënimi në maksimum prej 10 vjetësh, 7 vjetësh dhe 5 vjetësh. Po sipas kërkuesit, edhe duke pasur parasysh se në seancën e datës 23.12.2024 prokuroria kishte pranuar kërkesën e gjykatës për saktësimin e akuzës sipas nenit 332/d, pika 3, të KPP-së, aktet e dorëzuara në gjykatë nga prokuroria quhet se nuk ishin paraqitur dhe paraburgimi për efekt të shuarjes së masës vazhdonte të llogaritej sikur çështja penale ishte akoma në hetim paraprak.

9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 35, datë 07.01.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se rezultonte e provuar se në datën 17.08.2023 ishte ekzekutuar masa e sigurimit personal ndaj kërkuesit, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikim i dokumenteve”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Mashtrimi” me pasoja të rënda, të kryera në bashkëpunim. Sipas asaj gjykate, në analizë të nenit 263, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, këto vepra penale siç kanë ardhur për gjykim parashikojnë sanksione penale deri në 10 vjet burgim, për rrjedhojë afatet e paraburgimit gjatë hetimit paraprak janë 6 muaj, afat që është zgjatur edhe me 1 muaj e 15 ditë. Por akuzat në ngarkim të kërkuesit janë cilësuar ndryshe nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake, i cili ka ftuar prokurorët të bënin ndryshimin e cilësimit të fakteve penale, ftesë që është pranuar dhe kërkuesi është akuzuar për veprën penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, e kryer në bashkëpunim të posaçëm, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal. Duke qenë përpara të njëjtit fakt penal, por me kualifikim tjetër, si dhe duke pasur në konsideratë se masa e dënimit në maksimum për këto vepra penale është 15 vjet, afati i paraburgimit është 12 muaj, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar se kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është depozituar në datën 29.03.2024, disa ditë përpara se të mbaronte afati 7 muaj e gjysmë i paraburgimit, i filluar gjatë fazës së hetimeve paraprake, dhe

që nga kjo datë ka filluar faza tjetër e gjykimit, ajo e seancës paraprake, e cila fillon me paraqitjen e kërkesës dhe jo kur bëhen veprimet administrative për shortimin e çështjes gjyqësore. Deri në momentin që gjyqtari i seancës paraprake nuk disponon në një nga format e parashikuara sipas neneve 332/c deri 332/dh të KPP-së, afatet e paraburgimit janë të ngrira/pezulluara ndërkohë që ai, pasi ka dëgjuar palët në seancë paraprake, ka marrë një sërë vendimesh të ndërmjetme, ndër to edhe sipas nenit 332/d, pika 3, të KPP-së, duke ftuar organin e akuzës të bëjë cilësimin e fakteve objekt gjykimi edhe për kërkuesin, e cila është pranuar. Gjykata ka vlerësuar se do të ishte përpara rastit të kthimit të akteve për korrigjimin ose saktësimin e akuzës nëse prokurori nuk do të vepronte pas ftesës së gjykatës, çka nuk është rasti konkret, pasi prokurori ka vepruar. Në këto kushte, sipas asaj gjykate, çështja vijon të jetë ende në seancë paraprake, për sa kohë nuk është disponuar me vendim të ndërmjetëm për ndonjërin nga të pandehurit, vendim që do të kthente çështjen në fazën e hetimeve paraprake, ndërkohë që seanca është shtyrë për t'u lënë kohë të pandehurve për mbrojtjen të tyre. Për rrjedhojë, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë nuk janë ezauruar afatet tërësore të paraburgimit dhe mosrespektimi i afatit 30-ditor nga gjyqtari për të konkluduar me vendim për kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq nuk sjell ndonjë pasojë ligjore. Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi.

10. Me vendimin nr. 31 (87-2025-41), datë 07.02.2025 GJKKO-ja e Apelit ka vendosur miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke arsyetuar se vendimi i ndërmjetëm i gjyqtarit të seancës paraprake për administrimin e provave të kërkuara nga mbrojtja nuk përfaqëson faktikisht dhe as juridikisht vendimin e tipizuar nga neni 332/ç i KPP-së, për sa kohë çështja nuk i dërgohet prokurorit për hetime të mëtejshme. Edhe vendimi për të ftuar prokurorinë për të ndryshuar kualifikimin e fakteve penale nuk mund të kualifikohet sipas pikës 3 të nenit 332/d të KPP-së, për sa kohë çështja nuk i dërgohet prokurorit për ndryshimin e akuzës penale. Në vlerësimin e asaj gjykate, regjimi juridik i akuzave të reja ndodh nga prokuroria edhe në fazën e hetimit paraprak, edhe në seancën paraprake ashtu edhe gjatë gjykimit në themel, sipas dispozitave përkatëse procedurale. Gjyqtari i seancës paraprake ka ftuar prokurorinë të ndryshojë kualifikimin juridik të fakteve penale historike, gjë që prokuroria e ka bërë, pa qenë nevoja për kthimin e akteve në hetimet paraprake. Ndryshimi i kualifikimit juridik në seancë paraprake automatikisht passjell edhe veprimin e afateve të reja të paraburgimit, jo më sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 263 të KPP-së, por sipas shkronjës “c” të kësaj dispozite. Në lidhje me pretendimin e ngritur rishtazi për vendimin e ndarjes së pjesshme të çështjes, gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk ka asnjë efekt juridik në paraburgimin

e kërkuesit, pasi megjithëse një pjesë e çështjes kthehet në fazën e hetimit, ky vendim nuk ka asnjë ndikim juridik në ecurinë procedurale të çështjes që ndodhet në gjykim në seancë paraprake. Po kështu, në këndvështrim të nenit 263, pika 7, të KPP-së, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se për sa ka ndodhur në datën 23.12.2024 në gjykimin në seancë paraprake, nuk rezulton se ka fakt penal të ri për të cilin të jetë zgjeruar objekti i procedimit penal, por është bërë rikualifikimi juridik i fakteve penale historike të proceduara penalisht dhe të sjella për gjykim. Po kështu, ajo ka vlerësuar edhe se ndryshimi i kualifikimit juridik të bashkëpunimit passjell automatikisht edhe ndryshim në akuzat e atribuuara të pandehurve për faktet penale historike objekt procedimi penal. Për rrjedhojë, në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit, masa e sigurimit do të ndryshojë regjimin juridik, duke vijuar me afatet e paraburgimit të parashikuara nga ligji sipas ndryshimit të kualifikimit juridik të faktit penal historik për të cilin po procedohet tashmë, sipas pikës 8 të nenit 263 të KPP-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

11. Me vendimin nr. 00-2025-699, datë 24.04.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së dhe se vendimmarrja e gjykatave të posaçme është në përputhje me ligjin procedural penal, jurisprudencën kushtetuese dhe atë njësuese të Gjykatës së Lartë. Sipas atij kolegji, gjykatat e faktit kanë argumentuar vendimmarrjen e tyre, duke mbajtur në konsideratë ecurinë e procedimit penal, si dhe faktin që Prokuroria e Posaçme ka reflektuar në lidhje me akuzat sipas orientimit të gjyqtarit të seancës paraprake në të njëjtën seancë, pa u disponuar kthimi i akteve për saktësimin e akuzave. Në kuptim të nenit 263, pika 1, të KPP-së, Kolegji Penal ka vlerësuar se duke qenë përpara të njëjtit fakt penal, por me një kualifikim tjetër, si dhe duke pasur në konsideratë se për këto vepra penale masa e dënimit në maksimum është 15 vjet burgim, afati i paraburgimit është 12 muaj, duke gjetur zbatim shkronja “c” e kësaj dispozite.

12. Në datën 12.02.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

13.1. *Liria personale* në drejtim të:

13.1.1. *Parimit të ligjshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar nenin 263, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së, pa pasur kërkuesi një akuzë për kryerjen e një veprë

penale me maksimum mbi 10 vjet burgim. Llogaritjen e afatit të paraburgimit gjykata e përcakton me interpretimin e saj dhe jo të bazuar në ligj, detyrim ligjor ky që buron nga neni 27 i Kushtetutës. Vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit nuk mund të jetë i pakufizuar dhe i pakushtëzuar nga detyrimi për justifikimin e kryerjes së veprimeve hetimore të domosdoshme në pikëpamje të kohëzgjatjes së tyre. Mosveprimi, zvarritjet dhe mungesa e dilijencës për të kryer veprimet hetimore të duhura në afate të arsyeshme dhe realisht të lidhura me akuzën përbëjnë ushtrim arbitrar të kompetencës nga prokurori. Edhe neni 263, pika 3, i KPP-së e lidh afatin e paraburgimit me akuzën që është ngritur ose që mund të ngrihet dhe jo me bashkimin e dënimeve ose shtimin e tij. Shtimi i dënimit me 5 vjet në këtë rast është bashkim dënimesh, por në versionin e dënimit më të rëndë të shtuar sipas neni 55, pika 2, të KP-së. Gjykata gabon kur këtë shtim e bën me maksimalen e dënimit të parashikuar nga neni 135 i KP-së.

13.1.2. *Ndryshimi i kualifikimit ligjor të fakteve penale është bërë nga gjyqtari i seancës paraprake, i cili me vendimin e datës 23.12.2024 ka orientuar prokurorin të kualifikojë faktet penale për kërkuesin edhe pse as kërkesa për gjykim, as akti i marrjes të tij të pandehur nuk ka asnjë fakt të pretenduar si penal për vjedhjen/mashtrimin në bashkëpunim me të pandehurin tjetër, duke qenë kështu përpara një akuze të re. Veprimet e kërkuesit dhe të të pandehurit tjetër deri në dorëzimin e studimit të fizibilitetit dhe nxjerrjen e urdhrin të prokurorit nuk janë vlerësuar si fakte penale nga prokuroria. Qëndrimi i gjykatave është në kundërshtim me nenin 332/ç të KPP-së, pasi akuzat kanë qenë të reja dhe jo saktësim. Bazuar në nenin 332/d, pika 2, të KPP-së ndodhemi përpara një hetimi paraprak, pasi akuzat e reja për një fakt të ri penal janë atribut i prokurorisë, por që kërkon edhe pëlqimin e të pandehurit për të vazhduar në atë fazë që është procesi. Sipas vendimit njësores të Gjykatës së Lartë vetëm me vendim përfundimtar të gjyqtarit të seancës paraprake afatet e paraburgimit vlerësohen si gjyqësore.*

13.2. *Parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë para ligjit, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në vendimin njësores nr. 00-2021-1134(62), datë 01.11.2021, ku vlerëson se marrja dhe administrimi i provave nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është vendim për plotësim hetimesh sipas nenit*

332/ç të KPP-së. Në rastin e kërkuarit, gjyqtari i seancës paraprake nuk ka pasur nevojë ta zbatonte të plotë këtë nen, pasi nuk kishte nevojë të orientonte prokurorin se cilat prova duhet të merrte dhe nuk kishte arsye t'i jepte kohë, pasi provat ishin paraqitur nga mbrojtja dhe ishin në dosje, për rrjedhojë e vetmja vendimmarrje ishte t'i administronte ato. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë argumentuar se mbi cilën bazë ligjore janë administruar provat nga gjykata e shkallës së parë dhe nëse nuk janë marrë sipas nenit 332/ç të KPP-së (plotësim hetimesh) cila është baza ligjore mbi të cilën janë bërë pjesë e fashikullit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të ndalet vetëm në verifikimin e kriterit të legjitimitimit *ratione materiae* të kërkuarit.

16. Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar cenimin e *lirisë personale* në drejtim të *parimit të ligjshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë ka zbatuar nenin 263, pika 1, shkronja "c", të KPP-së pa pasur kërkuari një akuzë për kryerjen e një veprë penale me maksimum mbi 10 vjet burgim. Sipas kërkuarit, vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit nuk mund të jetë i pakufizuar dhe i pakushtëzuar nga detyrimi për justifikimin e kryerjes së veprimeve hetimore të domosdoshme në pikëpamje të kohëzgjatjes së tyre. Po sipas kërkuarit, shtimi i dënimit me 5 vjet në këtë rast është bashkim dënimesh, por në versionin e dënimit më të rëndë të shtuar sipas

neni 55, paragrafi 2, të KP-së dhe gjykata ka gabuar kur këtë shtim e ka bërë me maksimalen e dënimit të parashikuar nga neni 135 i KP-së. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se ndryshimi i kualifikimit ligjor të fakteve penale është bërë nga gjyqtari i seancës paraprake, duke orientuar prokurorin të kualifikojë faktet penale edhe pse as kërkesa për gjykim, as akti i marrjes si i pandehur nuk ka asnjë fakt të pretenduar si penal për vjedhjen/mashtrimin në bashkëpunim, duke qenë kështu përpara një akuze të re, në kundërshtim me dispozitat e KPP-së. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm me atë në vendimin njëses të saj të datës 01.11.2021, ku ka vlerësuar se marrja dhe administrimi i provave nga gjyqtari i seancës paraprake nuk është një vendim për plotësim hetimesh sipas nenit 332/ç të KPP-së.

17. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese. Çështjet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, mund të merren në konsideratë në gjykimin kushtetues vetëm nëse cenohen të drejta ose liri kushtetuese themelore (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kolegji, bazuar në aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, vëren se kërkuesi u është drejtuar gjykatave të zakonshme me kërkesë për konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arresti në burg” dhe nëse janë kushtet për caktimin e një mase sigurimi caktimin ndaj tij të një mase më të butë. Ai ka pretenduar se ndodhet në kushtet e nenit 263, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, pasi kanë kaluar 6 muaj nga fillimi i zbatimit të paraburgimit pa u dorëzuar aktet në gjykatë, referuar masës së dënimit për veprat penale për të cilat është akuzuar ai.

19. GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka gjetur të pabazuar kërkesën për shuarjen e masës, duke vlerësuar se kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq është depozituar disa ditë përpara se të mbaronte afati i paraburgimit i filluar gjatë fazës së hetimeve paraprake, datë nga e cila ka filluar faza tjetër e gjykimit, ajo e seancës paraprake, që fillon me paraqitjen e kërkesës dhe jo kur bëhen veprimet administrative për shortimin e çështjes gjyqësore. Po kështu, edhe pse ndodhej përpara të njëjtave fakte penale, organi i akuzës e ka pranuar ftesën e gjyqtarit të seancës paraprake për ndryshimin e cilësimit të këtyre fakteve penale objekt gjykimi, duke u akuzuar kërkuesi për vepra penale për të cilat masa e dënimit në maksimum është 15 vjet burgim dhe afati i paraburgimit është 12 muaj. Në vlerësimin e asaj gjykate, deri në momentin që gjyqtari i seancës paraprake nuk disponon në një nga format e parashikuara sipas neneve 332/c deri 332/dh të KPP-së, afatet e paraburgimit janë të ngrira/pezulluara. Për rrjedhojë, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nuk janë ezauruar afatet tërësore të paraburgimit.

20. Ky vendim është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, e cila ka arsyetuar se masa e sigurimit personal e caktuar ndaj kërkuesit do të ndryshojë regjimin juridik, duke vijuar në afatet e paraburgimit të parashikuara nga ligji sipas ndryshimit të kualifikimit juridik të faktit penal historik për të cilin tashmë ai po procedohet, sipas pikës 8 të nenit 263 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, ndryshimi i kualifikimit juridik nga prokuroria ose gjykata nuk passjellin caktimin e masave të reja të sigurimit. Ajo ka vlerësuar se transformimi i akuzës në seancë paraprake nuk ka sjellë në procedimin penal asnjë fakt të ri penal historik, por është kufizuar vetëm me rikualifikimin ndryshe të fakteve penale historike tashmë të proceduara penalisht nga Prokuroria e Posaçme, e cila ka saktësuar akuzat sipas orientimit të gjyqtarit të seancës paraprake.

21. Ky arsyetim i gjykatave të fakti është gjetur i drejtë edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk konstatohej asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së. Sipas atij kolegji, në rrethanat procedurale të verifikuara deri në atë fazë të procedimit, kur gjyqtari i seancës paraprake nuk ka disponuar kthimin e akteve, për rrjedhojë çështja vijon në seancë paraprake, afati i paraburgimit i konsumuar gjatë seancës paraprake nuk konsiderohet afat hetimor.

22. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rastin konkret gjykatat e zakonshme, pasi kanë marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit për shuarjen e masës së sigurimit të dhënë ndaj tij, kanë vlerësuar dhe arsyetuar se përse ajo është e pabazuar. Sipas tyre, masa e sigurimit personal e caktuar ndaj kërkuesit ndryshon regjimin juridik, duke vijuar në afatet e paraburgimit të parashikuara nga ligji sipas ndryshimit të kualifikimit juridik të faktit penal

historik për të cilin tashmë ai po procedohet, sipas pikës 8 të nenit 263 të KPP-së. Nga ana e saj, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se interpretimi i gjykatave më të ulëta për llogaritjen e afatit të paraburgimit është në përputhje me vendimin njësesues të asaj gjykate dhe sikurse kanë arsyetuar gjykatat e faktit ato nuk kanë disponuar me kthimin e akteve, pra afati i paraburgimit i konsumuar gjatë seancës paraprahe nuk konsiderohet afat hetimor.

23. Në vlerësimin e Kolegjit, pretendimet e kërkuessit kanë të bëjnë, në thelb, me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, çka jo vetëm është atribut i atyre gjykatave në përputhje me kompetencat e tyre, por as nuk mund të vihet në dyshim në rastin konkret për sa kohë që arsyetimi i atyre gjykatave nuk duket të jetë alogjik ose arbitrar, ose të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë. Vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar dhe rrëzuar kërkesën e kërkuessit për konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit “Arresti në burg” janë arsyetuar mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar dhe shteruese pretendimeve të ngritura nga kërkuessi, duke përmbushur kështu elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, ka vlerësuar se ato nuk janë të tilla që të vënë në dyshimin vendimin objekt rekursi. Vetëm fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim nga pikëpamja kushtetuese procesin gjyqësor të zhvilluar në atë gjykatë. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuessit janë haptazi të pabazuara.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.